



**BULETINI**



## Përmbajtja

- ▶ Aspektet zhvillimore të KOSTT-it nga mëvetësimi, dhe objektivat zhvillimore në të ardhmen 3
- ▶ Inaugurohet Nënstacioni më modern 400/110/10.5 kV në Kosovë, i cili do të krijojë kushte për zhvillimin industrial dhe ekonomik të Rrafshit të Dukagjinit dhe Kosovës Qendrore 4
- ▶ Përgatitjet e KOSTT për anëtarësim në ENTSO-E 5
- ▶ Vendimet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT gjatë periudhës shtator 2009-janar 2010 5
- ▶ Operimi aktual i tregut të energjisë elektrike në Kosovë 6
- ▶ Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë shpreh besimin në forcimin e bashkëpunimit në sektorin e energjisë Kosovë-Shqipëri 6
- ▶ Ndërtimi i autostrades energjetike në mes të Shqipërisë dhe Kosovës bëhet realitet: Qeveria Federale e Republikës së Gjermanisë dhe KfW Entwicklungsbank japin kredinë e parë për Republikën e Kosovës 7
- ▶ KOSTT ndihmon zonat e përmbytura në Republikën e Shqipërisë 7
- ▶ Bashkëpunimi Kosovë-Mali i Zi në fushën e energjetikës dhe avancimi i KOSTT dhe Sistemit Elektrik të Kosovës në regjion dhe më gjerë 8
- ▶ Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar z.Peter Faith shprehu përkrahjen e tij për avancimin e pozitës së KOSTT në nivelin rajonal dhe Evropian 8
- ▶ Kosova shpалosi projektet energjetike para investitorëve 9
- ▶ Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë gjatë periudhës Shtator 2009-Janar 2010 9
- ▶ Bashkimi European mbështetë Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT në mënyrë të vazhdueshme 10
- ▶ Operim më i avansuar i SEE të Kosovës përmes infrastrukturës së re SCADA/EMS 10

Buletini është publikim i KOSTT sh.a,  
 Rr. Iljaz Kodra p.n, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
 Tel: +381(0) 38 501 601 174 ; email: info@kostt.com  
 Web: www.kostt.com

Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:  
 Zana Bajrami-Rama, menaxhere për komunikim  
 zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com

## Aspektet zhvillimore të KOSTT-it nga mëvetësimi, dhe objektivat zhvillimore në të ardhmen

**T**ani më kanë kaluar 4 vite që nga dita kur KOSTT është ndarë nga kompania vertikalisht e organizuar KEK. Në kohën mu para pavarësimit si kompani, gjatë negociemeve të këtij statusi u paraqiten edhe dyshime se si do të shkoj zhvillimi i Operatorit të Transmisionit, Sistemit dhe Tregut, si një entitet i pavarur. Ndër të tjera, për të hequr dorë nga ky synim, janë deklaruar edhe vlera të kostos së një entiteti të tillë edhe dy here më të mëdha se ato të realizuara në ndërkohë. Tani, mund të thuhet se me gjithë dyshimet e shprehura në atë kohë, përcaktimi për të vendosur një kompani të mëvetme dhe me përgjegjësi të ndara në sistemin elektrik të Kosovës, ka qenë shumë e qëlluar. Dëshmia më e mire për këtë, është niveli i arritur i performances që realizon duke i bërë shërbimet klientëve të vet. Nga perspektiva e sotme, kjo mund të tregohet nga mungesa e kapaciteteve transmetuese deri 20% në raport me ngarkesën maksimale në nismën e mëvetësisë, ndërkohë që tani janë këto kapacitete 10-15% më të larta. Përveq këtij produkti themelor të KOSTT-it, paralelisht është arritur edhe një performancë financiare e volitshme në kushtet e Kosovës dhe ate brenda nivelit të kostos sipas standardeve ndërkombëtare.

Shtylla e tretë e zhvillimit, i referohet ngritjes së kapaciteteve dhe shkathtësive të stafit që të jetë në gjendje të ballafaqohet me sfidat që dalin nga mandatet e KOSTT të përfshira në kontratën e saj ndaj përdoruesve (klientëve) dhe në ligjet bazë të energjisë.

Pozita aktuale e KOSTT paraqet një mundësi shumë reale që në të ardhmen jo shumë të largët, të shëndrrohet në një kompani me një qëndrueshmëri financiare stabile, që mund të siguroj vetë-zhvillim nga fakti i të pasurit kapacitete të mjaftuara kredimarrëse për këtë.

Cilat janë objektivat në të ardhmen që KOSTT duhet të synoj ti arrijë, e që sigurojnë të qenurit një kompani me standard tërësisht kompatibil me ato evropiane dhe kështu, të jetë në gjendje të ofroj shërbime të kualitetit të lartë dhe që nuk dallojnë nga ato të kompanive të efikasitet të lartë?

Objektivat do të jenë ato që do të kërkojnë vëmendje të posaqme me që natyra e tyre paraqitet të jetë komplekse dhe kërkon përkushtim, guxim dhe ekspertizë të lartë e që mund të renditen si vijon:

- Zhvillimi dhe modernizimi i infrastruktures;
- Ngritja e kapaciteteve të operimit të sistemit si një anëtare e ardhshme e asociacioneve evropiane të transmisioneve;
- Ngritja e kapaciteteve në përballimin e kërkesave zhvillimore në tregun e energjisë elektrike të brendshëm dhe regional;
- Vazhdimi i ngritjes së performancës teknike dhe
- Stabilizimi i performancës financiare që do të krijoj një bazë të mjaftuar të vet zhvillimit duke mos u mbështetur më në suportet financiare të donatorëve vendor dhe ndërkombëtar.

Për sa i përket zhvillimit të infrastruktures, aktualisht risku është

i nivelit të ulët dhe për një periudhë jo më të gjatë se prej tri vitesh kjo objektive do të arrihet dhe do të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e standardeve ndërkombëtare dhe kodeve të adoptuara nga Kosova.

Ngritja e nivelit të performances së operimit të sistemit paraqitet të jetë më komplekse dhe me shumë rrisqe e që i referohet dy komponenteve:

- Ngritjes së kapaciteteve të KOSTT që do jenë tërësisht në pajtueshmëri me nivelet evropiane me sistemin e së cilës operojmë në mënyrë sinkrone, dhe
- Gadishmëria e produkteve në tregun e brendshëm dhe atij regional që të ofroj produkte që mundësojnë një operim të standardeve ndërkombëtare (produktet e gjeneratorëve dhe nga ngarkesa)

Prandaj një vëmendje e posaqme duhet të i kushtohet çështjes së operimit të sistemit në të ardhmen e afërt.

Gjithashtu edhe zhvillimet e tregut të energjisë elektrike paraqiten me shumë sfida dhe rrisqe për KOSTT, dhe vëmendja duhet të përqëndrohet në ngritjen e kapaciteteve të duhura për tu ballafaquar me kërkesat e tregut të energjisë elektrike. Edhe ky obligim i referohet parametrave të cilët jo gjithmonë varen nga KOSTT, prandaj kërkohej një syqeltësi në zvoglimin e rrisqeve dhe të sigurohet një treg transparent dhe likuid.

Performanca financiare është sfida e një shkalle të lartë të riskut posaqërisht duke pasur parasysh se faktorët e shumtë të jashtëm janë më ndikues se vet efikasiteti i KOSTT. Ky risk konsiderohet si më i larti me që nga kjo performancë varen të gjitha të tjerat të përmendura më lartë.

Nuk duhet neglizhuar edhe rrisqet eventuale që mund të reflektojnë nga ndonjë perceptim i gabuar që mund të krijohet ndaj KOSTT gjatë komunikimit me palët e interesit dhe publikun e gjerë. Prandaj, KOSTT duhet të ketë një përkushtim të posaqëm në përpjekjet për t'u prezentuar me vlerat e saja reale.

Në përfundim, nuk duhet të mos përmenden edhe parametrat motivues ndaj të cilëve gjithashtu duhet kushtuar vëmendje, meqenëse ato paraqesin faktorin shumë përcaktues për të ardhmen e KOSTT. Operimi i një kompanie të kësaj natyre me kërkesë të ekspertizave të larta për shumicën e stafit të vet shpie në drejtim të ndërtimit të politikave të zhvillimit të stafit, të një ekspertize të lartë e cila merr shumë kohë dhe kërkon investime. Prandaj, edhe politikat e motivimit duhet të zhvillohen në drejtim që mundësojnë qëndrueshmëri të nivelit të lartë të ekspertizës. Në mënyrë të vazhdueshme duhet të përqëndrohet vëmendja e këtij aspekti zhvillimor i cili paraqet garancë për arrijten e performancave të KOSTT.



Naim Bejtullahu

## Inaugurohet Nënstacioni më modern 400/110/10.5 kV në Kosovë, i cili do të krijojë kushte për zhvillimin industrial dhe ekonomik të Rrafshit të Dukagjinit dhe Kosovës Qendrore

**M**e 17 nëntor 2009, në afërsi të Istogut, në praninë e delegacionit të lartë të Qeverisë së Kosovës, Ambasadës Gjermane dhe akterëve kyç vendorë dhe ndërkombëtarë të sektorit të energjisë, u bë inaugurimi i Nënstacionit 400/110/10.5 kV Peja 3.

Kryeministri i Kosovës z.Hashim Thaçi, ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë z.Hans Dieter Steinbach dhe Drejtori Menaxhues i KOSTT z.Fadil Ismajli shoqëruar dhe nga Ministria e Energjisë dhe Minierave znj.Justina Shiroka-Pula, kanë prerë shiritin e kuq në hyrje të Ndërtesës Komanduese të Nënstacionit Peja 3, prej ku Kryeministri i Kosovës z.Hashim Thaçi edhe solemnisht ka energjizuar (vënë në punë) Nënstacionin PEJA 3. Implementimi i Paket Projektit Peja 3 ka filluar me 7 Nëntor 2008, kur është vënë gurthemeli i Nënstacionit dhe saktësisht pas një viti është kompletuar në afatin e parashikuar nga

KOSTT për të avancuar dhe zhvilluar sistemin e transmisionit të Republikës së Kosovës, ngritjen e kapaciteteve transmetuese dhe me këtë përmirësimin e kualitetit të furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmisionit për qytetarët e vendit.

Kryeministri i Kosovës z.Hashim Thaçi, gjatë fjalimit të mbajtur



në Nënstacionin Peja 3 theksoi se “Qeveria e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të ketë në vëmendje të veçantë sektorin elektroenergetik e sidomos sistemin e bartjes”.

Ndërkaq Drejtori Menaxhues i KOSTT z.Fadil Ismajli ka cilësuar se “Kjo njëherit është edhe sinjal i qartë për investitorët potencialë, që në Kosovë do të gjejnë një transmisioni i cili do të akomodon kërkesat e tyre dhe garanton një qasje të barabartë për të gjithë në rrjetin e transmisionit.”

Që nga sot, kapacitetet transmetuese të energjisë elektrike të vendit tonë nga 930 MW rriten në 1200 MW, ndërkaq kualiteti i energjisë elektrike me të cilën furnizohen qytetarët e Rajonit të Dukagjinit dhe Kosovës Qendrore do të jetë më kualitativ dhe do të mundësojë kushte për zhvillimin industrial dhe ekonomik të kësaj pjese të vendit tonë.

Përfitimi vjetor nga ky projekt vlerësohet të jetë rreth 5.6 milionë Euro, ndërkaq siç theksoi drejtori menaxhues i KOSTT z.Fadil Ismajli, “përfitimet gjithashtu do të jenë të ndjeshme edhe në aspektin rajonal sepse Sistemi Elektroenergetik i Kosovës tani do të shfaqet si nyje edhe më stabile e më e sigurtë për regionin”.

kontraktuesi/konsorciumi SIEMENS (Vjenë)/UMEL Dalekovodmontaza (Tuzla) që ka implementuar projektin e ndërtimit të Nënstacionit Peja 3 dhe linjave të reja ndërlidhëse të tensionit 400 kV dhe 110 kV.

Vlera e Paket Projektit Peja 3 është 23.3 milion Euro, prej të cilave 12.3 milion € financohen në formë granti nga nga Qeveria Gjermane përmes Bankës për Zhvillim (KfW) dhe 11 milion € financohen në formë granti nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ndërkaq Komuna e Istogut ka ndarë truallin prej 6 hektarëve për ndërtimin e Nënstacionit Peja 3.

Nënstacioni 400/110 kV Peja 3 tashmë është Nënstacioni më modern në Kosovë dhe njëherësh është Nënstacioni i parë dhe më i rëndësishmi që është ndërtuar në sistemin e transmisionit të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës që nga vitet e 80-ta. Me implementimin e këtij projekti, dëshmohet përkushtimi i

## Përgatitjet e KOSTT për anëtarësim në ENTSO-E

**K**ërkesa gjithnjë në rritje për energji elektrike dhe liberalizmi i tregut të energjisë elektrike janë faktorët udhëheqës të cilët kanë imponuar ndryshimet në mënyrën se si operohen sistemet elektroenergetike dhe si menaxhohet me resurset energjetike të vendeve në mbarë Evropën.

Këto rrethana kanë imponuar ristrukturimin e sektorëve të energjisë elektrike dhe krijimin e organizatave dhe mekanizmave që sa më lehtë dhe në mënyrë efikase të përmbushet kërkesa për energji. Një ndër këto organizata është edhe asociacioni i operatorëve të sistemit të energjisë elektrike në Evropë (ENTSO-E – European Network of Transmission System Operators for Electricity), e cila në vete ka ngërthyer funksionet e ish UCTE dhe ETSO, përkatësisht funksion teknik dhe komercial.

KOSTT si operator i licencuar i sistemit dhe tregut të energjisë elektrike të Kosovës dhe duke pasur parasysh detyrimet që dalin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë Elektrike në EJL, i ka vënë vetës për objektive që në afat sa më të shkurtër të anëtarësohet në këtë asociacion.

Lidhur me këtë janë mbajtur një sërë takimesh me akterët relevant vendor dhe ndërkombëtar, të cilët fuqishëm kanë mbështet nevojën e anëtarësimit. Prandaj, duke njohur rëndësinë që KOSTT të jetë i përfaqësuar barabartë në të gjitha organizatat rajonale dhe ndërkombëtare brenda KOSTT është themeluar një Grup Veprues i cili ka për detyrë të përgatisë të gjitha procedurat e nevojshme dhe dokumentacionin relevant për anëtarësim, dhe atë sipas kushteve për anëtar të ri të përcaktuara në Statutin e ENTSO-E.

Puna e Grupit mbikëqyret nga menaxhmenti i lartë i KOSTT dhe strukturat tjera qeverisëse të kompanisë.

Në kuadër të punës së këtij Grupi janë përgatitur të gjitha



procedurat e kërkuara për operimin e sigurtë dhe të besueshëm të sistemit në pajtim me Politikën e Doracakut Operativ të UCTE/ENTSO-E. Gjithashtu, detyrë e këtij grupi është edhe të përgatisë dokumentet tjera relevante dhe siguroj koordinimin me palët e interesit në sektorin e energjisë në Kosovë.

Ndër të tjera, si rezultat i aktiviteteve të këtij grupi KOSTT ka nënshkruar disa marrëveshje teknike bashkëpunimi me pjesëmarrësit e sektorit të energjisë në Kosovë dhe jashtë vendit, siç është Marrëveshja për Shërbime Ndhimëse me KEK, Marrëveshja për Shërbime Ndhimëse me KESH – Shqipëri, Marrëveshje e Interkoneksionit me OST e Shqipërisë, dhe ka iniciuar bisedimet me OST e Malit të Zi (PRENOS) për nënshkrimin e Marrëveshje së Interkoneksionit.

Në drejtim të anëtarësimit gjithashtu janë mbajtur takime konsultative me udhëheqësit e ENTSO-E, ku është diskutuar progresi i KOSTT si dhe mënyra e avancimit të mëtejshëm të këtij procesi.

Besoj, se kjo objektive e rëndësishme për KOSTT do të arrihet brenda afatit të parashikuar, dhe se me këtë KOSTT do të përfaqësohet si duhet në strukturat dhe organizatat për energji elektrike në rajon dhe Evropë, dhe nëpërmjet kësaj më tej avancoj operimin e sigurtë të sistemit dhe administrimin transparent të tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

## Vendimet e Bordit të Drejtorëve të KOSTT gjatë periudhës shtator 2009-janar 2010

Që nga konstituimi i Bordit të ri të Drejtorëve të KOSTT në mes të vitit 2009, në takimet e rregullta mujore të Bordit janë shqyrtuar çështje strategjike të kompanisë si dhe janë marrë vendime dhe janë miratuar dokumente të rëndësishme primare për ushtrimin e aktiviteteve afariste të kompanisë. Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka aprovuar Statutin e ri të kompanisë në pajtim me vendimin e Qeverisë nr.03/74. Gjithashtu gjatë periudhës tetor 2009-janar 2010 janë aprovuar Plani i Biznesit të KOSTT për vitin 2010, Buxheti për vitin 2010, Plani i prokurimit 2010, Kodi Disiplinor, Politika e nivelit të autorizimeve konform Ligjit për NP dhe Statutin të KOSTT, Manualin e punëtorëve etj.



## Operimi aktual i tregut të energjisë elektrike në Kosovë

**K**osova si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) ka si objektivë implementimin e Acquis Communautaire me qëllim të :

1. Krijimit të një tregu konkurrues duke rritur sigurinë në furnizimin me energji elektrike me një çmim të arsyeshëm, me shërbime të nivelit të lartë dhe ndikim sa më të vogël në ambient
2. Pjesëmarrjes në tregun regional dhe Evropian të energjisë elektrike
3. Nxitjes së investimeve private në sektorin e energjisë

Për ti përmbushur kërkesat nga TKE, Qeveria e Kosovës që nga viti 2004 ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për rristurimin e sektorit të energjisë duke përgatitur bazën ligjore dhe rregullative. Fillimisht është bërë shturja e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) si kompani vertikalisht e integruar dhe janë krijuar dy kompani të reja: (i) KOSTT SH.A- kompani me monopol natyror e rregulluar dhe përgjegjëse për ta operuar sistemin elektro energjetik dhe tregun e energjisë elektrike në Kosovë dhe (ii) KEK SH.A- kompani e rregulluar përgjegjëse për gjenerimin e energjisë elektrike dhe furnizimin e konsumatorëve të Kosovës me energji elektrike.

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është duke u zhvilluar në fazë, paralel me zhvillimet në sektorin e energjisë në Kosovë dhe zhvillimet në tregjet regionale. Modeli aktual i tregut në Kosovë është një model bilateral tranzicional me një numër të vogël të

pjesëmarrësve në treg ku KEK-u luan një rol dominant në gjenerimin dhe furnizimin me energji elektrike.

Zhvillimet momentale në sektorin e energjisë si procesi drejt privatizimit të distribucionit dhe furnizimit, nxitja e investitorëve për investime në projektin Kosova e Re dhe anëtarësimi i KOSTT në ENTSO-E kërkojnë kalimin nga faza ekzistuese e modelit të tregut në një fazë më të avancuar dhe kështu dizajnimin e një tregu të energjisë elektrike të përshtatshëm për investimet në sektorin e energjisë elektrike i cili do të jetë në harmoni me kërkesat që dalin nga TKE.

Procesi i dizajnit të tregut ka filluar, dhe KOSTT luan një rol të konsiderueshëm në procesin e dizajnit të tregut së bashku me ZRrE dhe këshilltarët e transaksioneve për të propozuar një model të përshtatshëm për kushtet e sektorit energjetik në të cilin gjendet Kosova. Parashihet që procesi për Dizajnin e Tregut të energjisë elektrike të përfundojë deri në Qershor 2010. Pas aprovimit të dizajnit të tregut nga MEM, Operatori i Tregut do të bëjë modifikimin e Rregullave të Tregut që të ju krijoj palëve në treg kushte lojale dhe jo diskriminuese të tregtimit me energji elektrike, dhe të cilat më pastaj i dorëzohen Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për aprovim.



Skender Gjonbalaj

## Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë shpreh besimin në forcimin e bashkëpunimit në sektorin e energjisë Kosovë-Shqipëri

Në vazhden e bashkëpunimit të frytshëm Kosovë-Shqipëri në sektorin e energjisë, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Shqipërisë z. Dritan Prifti i ka drejtuar një letër përkrahëse Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z. Fadil Ismajli, ku shpreh besimin në forcimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve tona.

Sipas Ministrit Prifti objektivi kryesor dhe konkret i bashkëpunimit Kosovë-Shqipëri është ndërtimi i linjës së re të interkoneksionit 400 kV Kosovë-Shqipëri.

Me ndërtimin e linjës së re 400 kV Kosovë-Shqipëri e cila planifikohet të fillojë gjatë këtij viti, do të rriten mundësitë e shkëmbimit më të madhë të energjisë elektrike në mes të dy vendeve. Aktualisht, Kosova dhe Shqipëria janë të lidhura me një linjë interkonektive 220 kV.



## Ndërtimi i autostrades energjetike në mes të Shqipërisë dhe Kosovës bëhet realitet: Qeveria Federale e Republikës së Gjermanisë dhe KfW Entwicklungsbank japin kredinë e parë për Republikën e Kosovës

**M**inistri i Ekonomisë dhe Financave, z. Ahmet Shala, drejtoresha rajonale për Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) znj. Ute Rodrian dhe Shefi Ekzekutiv i KOSTT z. Fadil Ismajli, me 23 dhjetor të vitit 2009, në Prishtinë nënshkruan Marrëveshjen për Kredi dhe Financim të linjës interkonektive 400kV Kosovë-Shqipëri.

Marrëveshja parasheh një buxhet prej €33,5 nga e cila €17,0 mil është kredi komerciale afatgjate me kushte kredituese të buta dhe €16,0 mil grant të Qeverisë Gjermane. Gjithashtu, pritet që të financohet nga KfW edhe pjesa e linjës në anën e Republikës së Shqipërisë.

Ndërtimi i linjës interkonektive të tensionit të lartë 400kV Kosovë-Shqipëri (Autostrada Energjetike) që siguron një rritje të kapaciteteve transmetuese të Republikës së Kosovës do të ndikojë në optimizimin e dy sistemeve, ngritjen në nivel më të lartë të sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve elektroenergjetike të Kosovës dhe Shqipërisë, dhe po ashtu do të ndikojë në zhvillimin e tregut të të dy vendeve si dhe tregut rajonal të energjisë elektrike.

Gjithashtu linja interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri, do të mundësojë shkëmbimin më të madh të energjisë në mes të dy vendeve sidomos pas ngritjes së kapaciteteve gjeneruese të planifikuara në Kosovë të bazuara kryesisht në linjit si dhe të kapaciteteve gjeneruese hidro të Republikës së Shqipërisë.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT së bashku me Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Republikës së Shqipërisë-OST tani më kanë filluar aktivitetet në përgatitjen e dokumentacionit

tenderues që pritet të përfundoj në Maj të vitit 2010 kur edhe pritet shpallja e interesit për gjetjen e kontraktuesit për ndërtim.

Planifikohet që në vjeshtën e vitit 2010 të bëhet edhe përzgjedhja e kontraktuesit dhe nga ky moment parashikohet ndërtimi i linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri në një afat optimal prej dy vitesh. Projekti në fjalë paraqet interkoneksion të rëndësishëm jo vetëm për Kosovën dhe Shqipërinë por edhe për rajonin. Realizimi me kohë i këtij projekti madhor të rëndësisë nacionale gjithashtu fuqimisht do të mbështetet nga Qeveria e Kosovës.

Me vënjen në operim të kësaj linje, sistemi i transmisionit të Republikës së Kosovës me të cilin operon KOSTT, edhe pse i vogël, do ta ketë rol edhe më të rëndësishëm si transmisioni i energjisë elektrike në Ballkan dhe Evropën Juglindore në përgjithësi.



### KOSTT ndihmon zonat e përmytura në Republikën e Shqipërisë

Pas situatës së rëndë të krijuar në fillim të këtij viti nga përmytjet që përfshinë rrethin e qytetit të Shkodrës dhe viseve të tjera të Shqipërisë, KOSTT ofroi një ndihmë në vlerë totale prej 7455 Euro.

Bordi i Drejtorëve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) mori vendim që të ndajë një ndihmë solidare prej 5000 (pesë mijë) Euro në mbështetje të Republikës së Shqipërisë për të tejkaluar sa më lehtë pasojat nga përmytjet.

Në letrën që i ka drejtuar Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z. Fadil Ismajli, Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Kosovë z. Islam Lauka, ka theksuar: “Pas kësaj situatë të jashtëzakonshme të krijuar, dëshiroj të shprehë keqardhjen time të sinqertë dhe të ndajë me ju dhimbjen për fatkeqësinë që ka kapluar Shqipërinë duke shkaktuar vërshime nga uji të shumë sipërfaqeve të tokës dhe të shtëpive të banimit [...] Uroj që gjendja e krijuar të tejkalohet sa më parë dhe sa më lehtë, dhe që jeta e qytetarëve të viseve të prekura të kthehet në normalitet. Shpresoj dhe uroj që Republika e Shqipërisë të mos përballlet më asnjëherë me situatë të tilla të jashtëzakonshme dhe që qytetarët të kenë progres në çdo fushë të jetës.”

Pas kësaj ndihme, një pjesë e punonjësve të KOSTT e kanë ndjerë të nevojshme që edhe ata të solidarizohen duke ndarë nga një shumë simbolike nga pagat e muajit Janar dhe në total janë mbledhur 2455 Euro.

“Kjo iniciativë që kanë ndërmarrë punonjësit e KOSTT, është kontribut simbolik në ndihmë të tejkalimit të situatës së rëndë që kaploi disa vise të Republikës së Shqipërisë pas përmytjeve këtë fillim vit. Urojmë që dëmet e shkaktuara dhe pasojat të rikuperohen sa më shpejtë dhe që qytetarët të vazhdojnë jetën normale në vendbanimet e tyre”, është shprehur me këtë rast, Drejtori i Burimeve Njerëzore në KOSTT z. Jusuf Imeri.

## Bashkëpunimi Kosovë-Mali i Zi në fushën e energjetikës dhe avancimi i KOSTT dhe Sistemit Elektrik të Kosovës në regjion dhe më gjerë

**N**ë fund të dhjetorit të vitit 2009, menaxhmenti i KOSTT në krye me Kryeshefin Ekzekutiv z.Fadil Ismajli, kanë prituri në një vizitë një ditore delegacionin e lartë të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Republikës së Malit të Zi në krye me z.Zoran Djukanovic, kryetar i Bordit të Drejtorëve të PRENOS Crna Gora.

Në takim, u diskutua për format dhe mundësitë e avansimit të bashkëpunimit në mes të Operatorëve të Transmisionit të dy vendeve fqinje Kosovë-Mali i Zi . Si tema të veçanta ishin mirëmbajtja e rrjetit elektrik të interkonjeksionit, vendosja e

fibrës optike (OPGW) në linjën interkonjektive 400 kV (kilovolt) që lidhë Nënstacionin Peja 3 (Kosovë) me Nënstacionin Ribarevina (Mali i Zi) që siguron lidhjen telekomunikuese në mes të Qendrës Dispečerike të Kosovës me atë të Malit të Zi, shkruarja e Marrëveshjes së interkonjeksionit si dhe shkëmbimi i përvojave në mes të kuadrove profesionale, e të tjera.

Kryeshefi ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli, është shprehur se “kjo ka qenë vizita e parë e delegacionit të lartë të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Malit të Zi në Kosovë pas luftës”. Sipas z.Ismajli një nga temat kyçe ishte iniciimi i Marrëveshjes për Interkonjeksion në mes të dy vendeve “e cila do të përcjellë progresin e KOSTT për anëtarësim në organizatën e Operatorëve Evropian të Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike (ENTSO-E)”.

Në anën tjetër Kryetari i Bordit të Drejtorëve të PRENOS nga Mali i Zi, z. Zoran Djukanovic u shpreh se “ne kemi diskutuar për shumë çështje, pasi që rrjeti transmetues paraqet një rrjet të gjallë, prandaj këto çështje duhet të përcjellen në vazhdimësi. z.Djukanovic u shpreh se PRENOS ka bashkëpunim shumë të mirë me KOSTT dhe ky takim ishte një vazhdimësi me qëllim të avancimit të sigurisë së operimit të sistemit energjetik, linjës interkonjektive dhe mirëmbajtjes së saj.”

Takimi u përmbyll me disa konkludime për bashkëpunim në mes të dy kompanive simotra në të cilat do të punohet në ditët në vijim.



## Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar z.Peter Faith shprehu përkrahjen e tij për avancimin e pozitës së KOSTT në nivelin rajonal dhe Evropian

Në takimin që zhvilloi Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli dhe bashkëpunëtorët e tij me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar në Kosovë z.Peter Faith, në fillim të këtij viti u diskutua rreth funksionimit të KOSTT si një nga akterët kyç në sektorin e energjisë në Kosovë.

Në vizitën e parë që i bëri KOSTT-it, z.Peter Faith, u shpreh i kënaqur me punën dhe menaxhimin e kësaj ndërmarrje publike duke e konsideruar si shembull të menaxhimit të mirë në Kosovë.

z.Fadil Ismajli, i prezantoi Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në Kosovë z.Faith, të arriturat e kompanisë dhe punën që është bërë deri më tani në ngritjen e kualitetit, sigurisë dhe besueshmërisë së Sistemit Transmetues të Kosovës përfshirë edhe aktivitetet në përgatitje të proceseve të privatizimit që janë duke u zhvilluar në sektorin e energjisë elektrike. Gjithashtu, z.Ismajli e njoftoi z.Faith me progresin e KOSTT karshi përgatitjeve për anëtarësim në ENTSO-E (Organizata Evropiane e Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike), në prag të dorëzimit të aplikacionit për anëtarësim në këtë institucion, që do të bëhet në fund të këtij muaji në Bruksel.



Me këtë rast, z.Peter Faith, potencoi gatishmërinë për të përkrahur KOSTT-in në përpjekjet për avancimin e pozitës së Sistemit Elektroenergjetik të Republikës së Kosovës në rajon dhe Evropë, derisa z.Ismajli ka shprehur mirënjohje për mbështetjen që ka ofruar deri më tani ICO-ja për KOSTT-in në këtë drejtim.



## Kosova shpalosi projektet energjetike para investitorëve

**N**ën organizimin e Alb- Konfindustrisë, KEK-ut, KOSTT-it dhe me mbështetjen e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, veçanërisht të ministres Justina Shiroka-Pula, në tetor të vitit 2009 u organizua Forumi Ndërkombëtar “Kosova-Mundësi Energjetike”.

Para pjesëmarrësve të shumtë në Forum, në mesin e të cilëve ishin të pranishëm përfaqësues të kompanive me renome botërore të gjenerimit, transmetimit, këshillëdhënies nga Austria, Italia, Shqipëria, Zvicra etj, u prezantuan mundësitë të cilat investitorët potencial mund ti gjejnë në Kosovë, si nga aspekti i resurseve natyrore, ashtu edhe nga infrastruktura ligjore dhe rregullative.

“Kosova ka potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim të shpejtë, dhe për këtë qëllim qeveria ka krijuar një mjedis shumë të sigurt dhe të favorshëm për investime në sektorë të ndryshëm. Legjislacioni dhe ligjet që zbatohen në Kosovë janë në përputhje të plotë me standardet evropiane dhe favorizojnë investimet private”, tha kryeministri i Kosovës z. Hashim Thaqi. Ndërkaq Ministria e Energjisë dhe Minierave znj. Justina Shiroka-Pula theks të veçantë i ka vënë përkushtimit të Qeverisë së Kosovës në përbushjen objektive të Bashkimit Evropian që deri në vitin 2020 të ngritet eficiencia e energjisë për 20 %, ngritja e burimeve të ripërtërishme për 20% si dhe zvogëlimin e emetimit të CO2 (dyoksidit të karbonit) për 20 %, si dhe në përbushjen e obligimeve nga Pako e 3-të e legjislacionit për energjinë elektrike të Bashkimit Evropian.

“Këto mundësi lindin natyrshëm nga pasuritë nëntokësore që ka ruajtur natyra, miliarda tonë qymyri të Kosovës, mundësitë e shumta të ngritjes së kapaciteteve për energji të pastër e nga riciklimi, e që fuqizohen edhe më tej përmes një infrastrukture moderne legjislative dhe fizike, si dhe politikave të zhvillim në drejtim të implementimit të politikave të BE-së për hapjen e tregut energjetik në rajon dhe implementim të reformave moderne në sektorin energjetik”, theksoi drejtori menaxhua si KEK z.Arben Gjukaj.

Kompanitë simotra që menaxhojnë sistemet e transmisionit të energjisë elektrike, përkatësisht KOSTT nga Kosova dhe OST nga Shqipëria bënë prezantimet e tyre rreth gjendjes aktuale të sistemeve dhe projekteve në implementim dhe atyre të ardhme. Fokus i veçantë ishte ndërtimi i linjës 400 kV (kilovolt) në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe zotimi për një operim të përbashkët në të ardhmen.

Të pranishmit në Forum, gjithashtu patën rastin që të njihen më për së afërmi me funksionimin, rolin dhe detyrat e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si një institucion i pavarur, përmes prezantimit të Kryesuesit të ZRrE-së z.Ali Hamiti.

Forum Ndërkombëtar i Energjisë ishte vend ku u takuan përfaqësues dhe ekspertë të shumtë të energjetikës nga vendi dhe ndërkombëtarë të cilët patën mundësi që të zhvillojnë diskutime rreth çështjeve energjetike dhe mundësive që i ofron Kosova për investitorët potencial.

Gjergj Buxhuku, Administrator i Përgjithshëm i Konfindustrisë tha se “Republika e Kosovës, si shteti ende më i ri në botë po tregon se mundësitë e saj të shumta energjetike të tokës dhe nëntokës, së bashku me pozicionin strategjik të vendndodhjes së saj, është e gatshme për t'i vënë në shërbim të rritjes së mirëqenies së qëndrueshme, jo vetëm të qytetarëve të saj, por edhe në shërbim të të gjitha vendeve të rajonit dhe më gjerë, si shembull i vullnetit për integrim të përbashkët sa më të shpejtë në BE”

“Shpresojmë që në mes të këtij dhe një Forumi të ardhshëm, të nisen projekte konkrete dhe ide të reja për zhvillimin e sektorit të energjisë në vend”, theksoi në përmbyllje të Forumit Kosova-Mundësi Energjetike, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli.



### Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë gjatë periudhës Shtator 2009-Janar 2010

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 29 dhjetor 2009, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka lejuar derogimin në zbatimin e dispozitave të disa neneve të Kodit të Rrjetit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit (V\_218\_2009)

-Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 30 tetor 2009, në bazë të kërkesës së KOSTT, ka lejuar derogimin në zbatimin e dispozitave të disa neneve të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit (V\_208\_2009)

## Bashkimi European mbështetë Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT në mënyrë të vazhdueshme

**P**ërkushtimi i Bashkimit European për përkrahjen e sektorit të energjisë në Kosovë është evident tash e 10 vite. Gjatë viteve të kaluara, Bashkimi European ka kontribuar në zhvillimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës me më shumë se 44 milion Euro, si investime direkte në projekte kapitale si dhe asistencë teknike.

Përveq faktit që KOSTT është dëshmuar si një kompani e menaxhuar dhe që operon me sukses, KOSTT gjithashtu njihet dhe si kompani që ofron mjedis miqësor dhe është partner serioz në implementimin e projekteve, ndërkohë që përfiton shumë nga ekspertiza e ofruar nga projektet e asistencës teknike.

Rishtazi, një raport monitorimi për projektin e asistencës teknike të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO) i cili po implementohet në KOSTT, është vlerësuar me rezultatet më të larta. Në këtë drejtim, Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli u shpreh se është “shumë mirënjohës për përkrahjen e Bashkimit European përmes ECLO. Në kërkesat tona për mbështetje ne jemi plotësisht të përkushtuar të përgjigjemi me gatishmëri të madhe për bashkëpunim. Duhet të theksoj se ne jemi të lumtur që kemi punuar me ekspertë shumë profesional dhe bashkë kemi arritur rezultatet më të mira në dobi të proceseve që janë duke u zhvilluar në KOSTT.”

KOSTT që nga ndarja e suksesshme nga KEK-u në vitin 2006, gjatë këtyre viteve ka vendosur kornizën ligjore dhe rregullative, siq janë kodet dhe standardet teknike, ka kryer studime të tjera relevante dhe ka hartuar dokumente në të cilat bazohet planifikimi, zhvillimi,

OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZISTA A.D.



mirëmbajtja dhe menaxhimi i Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike në Kosovë. Për më tepër, KOSTT ka ngritur kapacitetet operative dhe çdo ditë është duke iu ofruar standardeve të kërkuara nga asociacionet e Komunitetit European në mënyrë



që t'i arrijë zhvillimet e ardhshme në Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike (IEM).

KOSTT njëkohësisht, shpreh mirënjohjen për ekspertizën e ofruar në projektin aktual nga kompanitë e konsulencës Terna dhe IPA Economics në procesin e implementimit të projektit.

Gjatë arritjes së rezultateve, KOSTT ka përfituar shumë nga ekspertiza e ofruar përmes projekteve për mbështetje teknike që janë siguruar ose sigurohen nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, e në këtë rast Bashkimi European përmes Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit European në Kosovë (ECLO).

Pas përfundimit të projektit aktual, KOSTT shpreson në përkrahjen e më tutjeshme nga Bashkimi Evropian në ngritjen e kapaciteteve operacionale.

## Operim më i avancuar i SEE të Kosovës përmes infrastrukturës së re SCADA/EMS

Grumbullimi i të dhënave, procesimi i tyre për përdorim nga operatorët dhe kontrolli i operimit të pajisjeve nga distanca janë blloqet fundamentale që ndërtojnë një sistem modern të kontrollit. Sistemet që i plotësojnë dhe përbushin këto funksione njihen si SCADA/EMS sisteme (Supervisory Control and Data Acquisition/Energy Management System).

Me zhvillimet e hovshme në fushën e lëmisë elektroenergjetike si dhe me rindërtimin e vazhdueshëm të operacioneve të tyre, SCADA/EMS u zhvillua në një shkallë të gjërë. Përderisa sistemet kompjuterike përmirësojnë gradualisht performancat dhe rrisin kapacitetet, konfigurimet e sistemeve komplekse tentojnë dhe ia arrijnë t'i përbushin kërkesat e tilla të parashtruara duke rifreskuar me risi pjesën softverike me qëllim të mirëmbajtjes dhe zhvillimit.

Filluar nga fundviti i 2008-ës KOSTT ka filluar procesin e implementimit të një sistemi të tillë modern të prodhuesit AREVA. Ky sistem përmban shumë tërësi funksionale si:

- Nën sistemin hardverik i cili përfshin: tërë pajisjet hardverike, komunikuese dhe kontrolleret programabil,
- Nën sistemin softverik i cili përfshin tërë modulet e aplikacionit dhe përkrah punën e hardverit
- Nën sistemin telekomunikues që mundëson komunikimin në mes të elementeve të sistemit SCADA/EMS
- Procesin teknologjik që paraqet sistemin në të cilin

mundësohet mbikqyrja, kontrolli dhe grumbullimi i të dhënave si dhe arkivimi i tyre.

EMS softveri është i dizajnuar të operoj në kohë reale në LANin që e suporton atë. Ekziston mundësia që modulet relevante softverike të përdoren për studim apo planifikim.

Ky softver siguron interfejsa të ndryshëm që iu mundësojnë personelit të Operimit të Sistemit qasje në parametrat dhe paraqitjet (display-at) që nevojiten për kontroll dhe monitorim të tij. Funksionet e tij mund të klasifikohen si në vijim:

**1. Funksionet monitoruese të sigurisë** që përfshijnë këto nënfunksiione: përpunimin e gjendjes së rrjetës energjetike, vlerësuesin e gjendjes (State estimator), parashikimin e ngarkesës në zbarra, zgjedhjen dhe analizën në kontigjent, llogaritjen e lidhjeve të shkurta, operimi me rrjedhën e ngarkesës, shpërndarjen e ngarkesës (Load shedding) dhe llogaritjen e kapaciteteve të disponueshme të transmisionit.

**2. Funksionet ekonomike të operimit** që janë: AGC (Automatic Generation Control), optimalizimi i rrjedhës së fuqisë, shpërndarja Volt-VAR dhe orari i shkëmbimit të energjisë me TSO tjerë, dhe

**3. Orari dhe funksionet e planit operativ** që kanë këto nënfunksiione: planifikimin afatshkurtë, orarin e çyqyqeve dhe funksionet e analizës së sistemit elektroenergjetik (rrjedha e ngarkesës, analiza në kontigjent, llogaritja e lidhjes së shkurtë).

(Arjeta Pajaziti)